

*“Deri sa mos ta ndryshojnë (pozitivisht)
gjendjen e tyre”*

PASOJAT E MËKATEVE

Profesor:
Amr Halid

Për botuesin **ERIXH LIN-NESHRI**

Autor:

Prof. AMR HALID

Titulli i origjinalit:

آثار الذنوب و المعاصي

Titulli:

PASOJAT E MËKATEVE

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Korrektor:

Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Mumin Shehu

Kaçanik

2006

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

Hyrje

Vërtet çdo falënderim i takon vetëm Allahut, prandaj ne vetëm Atë e falënderojmë, vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, nuk kërkojmë udhëzim tjetër pos çka na udhëzon Ai, Atij i kërkojmë falje, i mbështetemi Allahut nga të metat tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Cilin e udhëzon Allahu, ai nuk humb kurrë, mirëpo cilin e humb Allahu, për të nuk ka udhëzues.

Përshtëndesim dhe dërgojmë salavate për më të mirin e krijesave, më të zgjedhurin dhe më të ndriturin - robin e Allahut dhe të dërguarin e Tij - Muhamedin a.s.. Përshtëndesim edhe familjen e tij të mirë dhe të pastër, shokët e tij të mirë dhe të pastër në përgjithësi, dhe ata të cilët i pasojnë gjurmët e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Ajo çka po ndodhë për çdo ditë tek muslimanët si: nënçmimi i ndërsjellët, urrejtja në mes vete, problemet, ndarja, përçarja, copëtimi, konfrontimi, hidhërimi etj., të gjitha këto na obligojnë neve që patjetër t'i lëmë dhe të largohemi prej kundërshtimeve mes vete, konfrontimeve, hidhërimeve, nënçmimeve.

Të gjitha këto na obligojnë të mbjellim parimin e vëllazërimit dhe çlirimit e zemrave në gjokset tonë, para se të bëhet vonë dhe para se të na shkojë jeta pa bërë punë të mira. Të gjitha këto na obligojnë domosdoshmërinë e kthimit sa më shpejt tek Allahu Gjithëfalës dhe i Gjithëfuqishëm; t'i lëmë anash konfrontimet, kundërshtimet, hidhërimet, nënçmimet dhe t'i lutemi Allahut që t'i lartësojë dhe t'i ngritë muslimanët edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, njëherit t'i mbrojë muslimanët nga nënçmimi, poshtërimi, ndarja, përçarja dhe shpërndarja.

Le të jetojnë në këtë dunja (botë) me nderë, fuqi, zhvillim dhe qeverisje, ndërsa në botën tjetër me vendbanimet me të larta të Xhenetit dhe shpëtim prej zjarrit të Xhehenemit. Kjo do të jetë vërejtje dhe dëshmi se vërtetë - **“Allahu kurrë nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”**

(Err Rra`d, 11)

Deri sa të arrijmë me këtë parim (maksimë) në çështjet më të rëndësishme dhe më madhore, përpos një pjese që i ka mbrojtur Allahu dhe i ka mëshiruar nga të tjerët, të tjerët janë në shkatërrim të zemrave të tyre dhe të muslimanëve, duke shkaktuar kundërshtime, konfrontime, ndarje dhe përçarje. Duhet të angazhohemi që ta heqim këtë ves të keq dhe virusin shkatërrimtar për të kaluar jetë të lumtur, të qetë dhe të mirë edhe në këtë botë, edhe në botën

tjetër. Për t'u angazhuar në përmirësimin dhe ndryshimin e gjendjes faktike të mjerueshme, e për të arritur në një gjendje të ndershme, të lartë, të ndërtuar mbi bazat e vëllazërimit, unitetit, fuqisë, krenarisë, deri tek triumfi dhe qeverisja Islame dhe e muslimanëve.

“Vërtetë Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre”.

(Err-Rra'd, 11)

* * *

PASOJAT E MËKATEVE

Përsëritës dhe i përcjellim selame më të mirit të robërve, më të mirit të krijesave – Muhamedit të dërguarit të Allahut, mbi familjen e tij të pastër dhe të ndershme, mbi shokët e tij bamirës, të sinqertëve në përgjithësi dhe kush i pason ata e shkon gjurmëve te tyre në punët më të mira deri ne Ditën e Gjykimit.

Çdo gjë çka u ndodhë muslimanëve për çdo ditë, si: vrasjet, dëbimi, uzurpimi i pronave dhe pasurive natyrore, kolonizimi i vendeve; çka u ndodh prej fatkeqësive tjera si: sëmundjet dhe humbjet e më të dashurve te tyre, sa që është mbushur gota e vdekjeve në vendet islame, në vend që të mbizotërojnë paqja dhe siguria. Të gjitha këto, sjellin në përfundim domosdoshmërinë e largimit prej mëkateve, para se të bëhet vonë dhe të na shkojë jeta pa mirësi dhe të mira.

Të gjitha këto sjellin përfundimin - domosdoshmërinë e kthimit sa më të shpejtë te Gjithëfalësi dhe i Gjithëfuqishmi, përlulen ndaj Allahut dhe kërkimet ndaj Tij, që ta ngritë islamin dhe muslimanët edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, që t'i shpëtojë muslimanët nga nënçmimi dhe poshtërimi, që muslimanët përfundimisht të zhvillohen dhe të përparojnë, me qëllim që të largohet e keqja, që Allahu xh.sh. të jetë i kënaqur me ta dhe të fitojnë begatitë e Xhenetit dhe të shpëtojnë prej zjarrit të Xhehenemit.

Kjo dëshmi, kjo vërejtje, ky premtim dhe ky kërcënim rezulton prej parimit - *ndryshimi dhe përmirësimi i pozitës dhe statusit të një populli (shteti), do të thotë, atëherë kur ta ndryshojë dhe përmirësojë çka ka në veten e tij* . Deri sa të realizojmë këtë parim dhe deri sa të vazhdojmë me këtë parim, në epiqendrën më të rëndësishme, shpirtlidhja e të gjithë njerëzve, të cilët i mëshiron dhe i mbron Zoti, jemi me mëkate dhe jemi të përlyer, dhe ashtu siç ceka me parë, është e domosdoshme largimi nga mëkatet për të arritur jetë të lumtur, të qetë dhe të mirë, në këtë botë dhe në botën tjetër.

Ai i cili dëshiron lumturi në të dy botët, patjetër duhet të largohet nga mëkatet dhe t'i zhdukë ato, njëherit t'i zëvendësojë me përlulshmëri dhe vepra të mira, me qëllim që të takojë Allahun e

Lartmadhëruar, të betohet me të mirë dhe t'i shpëtojë Xhehenemit.

Për Zotin, shpresoj se kjo porosi do t'i bëjë dobi çdo njerit i cili e lexon, për të qenë një kontribut i madh dhe i vazhdueshëm deri në Ditën e Gjykimit.

Allahu ka fuqi për çdo send, Ai është kompetent për çdo send, Ai ka mundësi për çdo send. Vetëm Atij i mbështetemi dhe nuk ka mbrojtës më të mirë se Ai.

MËKATET SHKAK I ÇDO FATKEQËSIE DHE I ÇDO TRAGJEDIE

Nuk ka dyshim se mëkati është shkak i çdo fatkeqësie dhe i çdo tragjedie, e kjo rregull vlen për individët, grupet e njerëzve, ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi. Për këtë arsye ai i cili është duke bërë mëkate vazhdimisht dhe pa ndërprerë duhet të largohet në tërësi prej mëkateve.

Çka ndikoi që Ademi a.s. të nxirrej prej Xhenetit?

- A nuk ishte mëkati?!

Çka ndikoi që Iblisi të largohet prej mëshirës së Allahut?

- A nuk kishte mëkati?!

Çka ndikoi në përmbytjen e popullit të Nuhut a.s.?

“Atëherë i hapëm dyert e qiellit dhe (i dënuam) me shi rrebesh, dhe të furishëm. Në të njëjtën kohë shpërthyem tokën dhe gufuan burime uji dhe u bashkuan njerëzit me urdhrin ashtu siç e kishim caktuar” (*El-Kamer, 11, 12*) Pra mëkati .

Çka ndikoi që Allahu të dërgojë një zë të fuqishëm te populli Themud?

“Ne dërguam kundër tyre një ushtimë, kur menjëherë ata u bënë si shtrojë vathi (mbeturinë e ushqimit të kafshëve që u shtrohet)”. (*El-Kamer, 31*)
Pra mëkati.

Çka ndikoi që të dërgohet era te populli Ad?

“Atëherë Ne, në një ditë fatkeqe të përjetshme për ta, dërguam një furtunë (erë të fortë), (e cila) i ngriste njerëzit si të ishin trupa hurmash të shkulura.” (*El-Kamer, 19-20*) Pra mëkati.
Çka ndikoi që Karunin, me punën e tij, ta fundosë vetë toka?

“Atë (Karunin) me tërë pasurin dhe pallatin e tij Ne e shafuam në tokë ...”. (*El-Kasas, 81*) Pra mëkati.

Çka ndikoi në shkatërrimin e popullit të Lutit a.s.?

“Ne pjesën më të lartë të qytetit e përmbysëm dhe e zbritëm në thellësi të tokës e shndërruam në më të poshtmen dhe lëshuam shi (të dheut të pjekur në Xhehenem) si gurë”.

(*El-Hixhër, 74*)

Vëlla!

Duhet të zgjohemi patjetër, duhet të largohemi patjetër nga mëkatet, para se të vjen koha kur nuk do të bëjë dobi as pendimi.

Transmetohet nga Umi Selamete - gruaja e Pejgamberit s.a.v.s. se e ka dëgjuar të Dërguarin Allahut s.a.v.s. duke thënë:

“Nëse umeti im mbushet me mëkate, atëherë Allahu i përfshin me dënimin e Tij”.

I kam thënë: - O i dërguari i Allahut, po në mesin e tyre a ka njerëz të devotshëm dhe të mirë? - Po gjithsesi do të ketë.

- Po si do të veprohet me ata?!

- Do ti godet fatkeqësia e cila i ka goditur të tjerët (me mëkatarët), e pastaj Zoti i shti në mëshirën dhe kënaqësinë e Tij”.

(Musnedi i Imam Ahmedit, 25382)

Vëlla!

Duhet ta ndiesh seriozitetin dhe rrezikun e shoqërisë.

Populli kalon në probleme të shumta, ndërsa në vazhdojmë me mëkatet e tona.

Kujdes që mos të bësh as mëkate të vogla, kujdes që mos të besh çfarëdo mëkati.

Abdullahu Ibn Mesudi r.a. transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Ruani veten tuaj nga të këqijat që vijnë prej mëkateve, sepse ato i përmbliiden njeriut deri sa ta shkatërrojnë atë”.

Mos iu afro mëkateve kurrë, lëri mëkatet. Nëse çdo individ i shoqërisë largohet prej mëkateve, atëherë mbi të gjithë ne do të largohen pikëllimet dhe fatkeqësitë, dhe do të përmirësohet statusi, dhe pozita jonë, Allahu do të na tejkalonte dhembjet, dhe do të na sillte në gjendjen më të mirë.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ai popull nuk e ndryshon gjendjen e tij”.

(Err-Rra'd, 11)

Vëlla!

Të këqijat e mëkateve nuk përmbliiden vetëm te individi, por përmbliiden edhe në shoqëri, deri sa ta shkatërrojnë atë.

Mos e lejo veten të shash apo ta nënçmosh shokun tënd;

mos e lejo veten t'i shikosh dhe t'i përcjellësh femrat;

mos e lejo veten të shpifësh dhe të përgojosh;

mos e lejo veten të dëgjosh këngë dhe muzikë e cila shkatërrojnë;

mos e lejo veten të mëkatosh;

mos i thuaj mëkatit po, por thuaji Jo!

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“... E konsideron të lehtë e të vogël, ndërsa ajo te Allahu është e madhe”.

(En-Nur, 15)

Transmetohet se Enes Ibn Maliku ka thënë:

“Do të punoni vepra të cilat në sytë e juaj do të duken më të vogla se kokrra e grurit, ndërsa ato vepra në kohën e të Dërguarit s.a.v.s. i kemi konsideruar të mëdha”.

Ebu Abdullahu në lidhje me këtë ka thënë:
“Kjo do të thotë veprat që shkatërrojnë”.

Transmetohet nga Hamid bin Helai se ka thënë: Ka thënë Ubadete bin Kurti:

“Vërtet ju do të veproni punë, të cilat në sytë e tuaj duken më të vogla se kokrrat e grurit, ndërsa në kohën e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. i kemi llogaritur prej mëkateve të mëdha”. Pastaj ka vazhduar: ia kanë treguar këtë Muhamed bin Sirinit, e ai më ka thënë: *Vërtet ashtu është.*

Ibn Kajim r.a. ka thënë: *“O mëkatar, ruaju se pas mëkatit pason e keqja e mëkatit!”*

Vëlla!

Gëzohesh me mëkatin tënd, ndërsa ta dish se je duke vepruar ashtu që Allahu atë mëkat tëndin ta shkruan mëkat të madh.

Ti qesh duke bërë mëkat, ndërsa nuk brengosesh se Allahu të sheh duke e bërë atë mëkat të madh.

Brengosesh pse nuk ke mundur të bësh mëkat, ndërsa nuk e di se kjo te Allahu është mëkat.

Ti ke dëshirë dhe po ashtu angazhohesh të fshihesh deri sa të bësh mëkat, që mos të të shohin të tjerët, kurse nuk brengosesh se të sheh Allahu, ndërsa para Allahut duhet të frikësohesh më shumë se prej të tjerëve.

Shumë pak, thuaja se fare, nuk turpërohesh nga melaqja e krahut të djathtë dhe melaqja e krahut të majtë, deri sa ata shkruajnë çdo gjë çka vepron, dhe të shohin çdo gjë çka vepron, e kjo te Allahu është më e madhe se mëkatet. Mëkatet nuk janë çështje të thjeshta, përkundrazi mëkatet shkatërrojnë shoqëri.

Kur muslimanët shkuan për ta çliruar Qipron, në mesin e ushtrisë muslimane ishte edhe Mudhafer Ebu Dardai r.a.. Pasi që u çlirua Qiproja muslimanët kishin zënë rob një qiprojan, muslimanët hynin (në tokën e Qipros) të gëzuar, ndërsa Ebu Dardai qante! Xhabir bin Nekiri i thotë: Ti po qanë, ndërsa kjo është dita kur Allahu ka ngritur islamin dhe muslimanët. Ebu Dardai iu përgjigj: Mjerë për ty, po a nuk po kupton! A e di se ky popull çfarë force dhe çfarë fuqie ka pasur, në krahasim me popujt tjerë, mirëpo kur lënë anash urdhrat e Allahut, ja se çka u bëri Allahu, i shndërroi në robër, e kur ta kthejë Allahu një popull në robëri, ai s'ka nevojë për atë popull, sepse nuk ka te Allahu mëkat më të madh se mosnënshtimi ndaj urdhrave të Tij.

Vëlla!

Shiko çfarë mendimi dhe çfarë fikhu ka pasur Ebu Dardai r.a.! Ai i ka perceptuar ligjet e Allahut (dhe ka ardhur në përfundim) se mëkatet e një populli janë shkak i shkatërrimit dhe shndërrimit të tij në gjendje shumë të vështirë.

Mirëpo, ende ka shpresë, e shpresa është te pendimi dhe kthimi në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar, sepse ne jemi popull për të cilin Allahu i Lartmadhëruar ka thënë:

“... populli më i mirë i dalur për tërë njerëzimin ...”.

Vërtet Allahu i Lartmadhëruar e do këtë umet, sepse është popull më i zgjedhur dhe më i mirë, i dalur për tërë njerëzimin, mirëpo Allahu nuk e ngrit askënd përderisa ata gabojnë, e kush gabon do t'i kuptojë pasojat dhe rreziqet e gabimeve të tij.

PASOJAT E MOS PËRFILLJES SË URDHRAVE TË ALLAHUT

Dëgjoni me vëmendje këtë që po ua përkujtoj, prej pasojave të mospërfilljes së urdhrave të Allahut, që ta kuptoni rrezikun, e menjëherë t'i urreni mëkatet dhe t'i çrrënjosni nga zemrat e juaja.

Prej pasojave dhe të këqijave të mëkateve janë:

1. Hidhërimi i Zotit të Lartmadhëruar

Pejgamberi s.a.v.s. thotë: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Unë jam Allahu, nuk ka zot pos Meje, nëse përfillen urdhrat e Mia, atëherë Unë jam kënaqur, nëse Jam i kënaqur bekoj dhe jap të mira, ndërsa të mirat e Mia nuk kanë fund, ndërsa nëse nuk përfillen urdhrat e Mia hidhërohem, e kur të hidhërohem dënoj”.

2. Urrejtja e muslimanëve ndaj tij

Imami shafi'u r.a. ka thënë: “Çdonjëri prej jush le të ruhet prej mallkimit të zemrave të muslimanëve, ndërsa ai nuk e di (nuk e heton). Kur e pyetën se, si ndodhë kjo?

Është përgjigjur: Nuk i përfillë urdhrat Allahut, e Allahu krijon urrejtje në zemrat e besimtarëve ndaj tij”.

3. Pakësimi i rizkut

Transmetohet nga Thubani r.a. se Muhamedi a.s ka thënë:

“Njeriut i pakësohet rizku, për shkak të mëkatimit të tij. Ndërsa nuk i kthehet ajo sasi vetëm se nëpërmjet duasë, po ashtu jetën e zgjat vetëm mirësia”.

(Ahmedi 2135, Ibn Maxhe, 4012)

Transmetohet prej Ibn Abasit r.a.se ka thënë:

*“Vërtet e mira ..., e shton dhe e zgjeron rizkun,
Vërtet e keqja ..., e pakëson rizkun”.*

4. Pakësimi i diturisë

Imam Shafiu i ka thënë këto vargje:

*U ankova te Allahu për vështirësi në të
mbajturit përmendësh*

Më udhëzoi që të largohem prej mëkateve

Më tha: Dituria është dritë

*Ndërsa drita e Allahut nuk i dhurohet
mëkatarit.*

5. Ndjeshmëria e distancës së madhe mes robit dhe Allahut të Lartmadhëruar

Mëkatarit e ndien thellë në shpirt se është larguar nga Allahu i Lartmadhëruar dhe kjo largësi nëse vendoset në një peshojë, atëherë tërë kënaqësia e kësaj bote nuk do ta peshonte, apo nuk do ta kompensonte hidhërimin e Allahut të Lartmadhëruar ndaj tij.

6. Ndjeshmëria e distancës së madhe mes robit dhe njerëzve

Transmeton Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:

*“Pasha Atë (Allahun) që shpirti i Muhamedit
është në dorën e Tij, çfarëdo ndarje në mes të dy
dashamirëve nuk ndodh, pa bërë mëkat ndonjëri
prej tyre”.*

Transmeton Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Çfarëdo ngjarje në mes dy dashamirëve që ndodh, ndodh për shkak të mëkateve të ndonjërit prej tyre”.

Disa prej dijetarëve të gjeneratave të para kanë thënë:

“Unë bëj mëkat, ndërsa atë mëkat e kuptoj se e kam bërë nëpërmjet sjelljeve të gruas ndaj meje dhe nëpërmjet kafshës sime ndaj meje”.

7. Pafytyrësia, padrejtësia dhe dobësimi i trupit

Ibn Abasi r.a. ka thënë:

“Vërtet mirësia është zbardhje e fytyrës, dritë e zemrës, zgjerim i furnizimit, fuqi në trup dhe dashuri në zemrat e tjerëve. Ndërsa, e keqja është nxirje e fytyrës (pafytyrësia), errësirë e zemrës, pakësim i rizkut dhe urrejtje në zemrat e njerëzve”.

Vëlla!

Vështro të gjitha këto pasoja të mëkateve, pas të gjitha këtyre - a ka vend për ndokënd për të mos i përfillur urdhrat e Allahut të Lartmadhëruar?!

Pa dyshim, çdo e keqe që u ndodh njerëzve, është shkak i mëkateve të tyre.

8. Pengimi i devotshmërisë dhe shpjerja në mëkate më të mëdha

Mëkati pengon devotshmërinë, në të njëjtën kohë shpie në mëkat më të madh. Mëkatari pengohet në falje të namazit p.sh: namazit të sabahut, ose namazit

të natës, bile e shtinë njeriun ta kalojë natën në lojëra të ndaluara, ta kalojë natën me shejtanët, Zoti na mbrojt prej tyre!

Mëkatari prodhon mëkatarë, ai i tërheq edhe të tjerët në mëkate, kështu që bëhet varg zinxhiror i mëkateve.

9. Sjellja e nënçmimit, poshtërimit dhe e humbjes së vlerës te Allahu i Lartmadhëruar

Mëkati është shkak i nënçmimit dhe poshtërimit, shkak i humbjes së vlerës, andaj devotshmëria sjellë begati dhe lartësi, ndërsa mëkati sjellë nënçmimin dhe Xhehenemin. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Cilin e nënçmon Allahu, ai nuk mund të lartësohet”.

(El-Haxh, 18)

Zoti i Lartmadhëruar po ashtu thotë:

“Ai i cili dëshiron forcë, fuqi e lartësi, le ta dijë se Allahu ka forcë, fuqi e lartësi mbi të gjithë”.

(Fatir, 10)

Transmeton Ibn Umeri r.a. se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Jam i dërguar para Ditës të Kijametit me shpatë, deri sa të mos adhurohet vetëm Allahu dhe të mos i bëhet shok Atij. Rizku im është nën hijen e shigjetave të mia, ndërsa nënçmimi dhe poshtërimi është me ata të cilët i kundërshtojnë urdhrat e mia dhe kush dëshiron t'i ngjasojë dhe t'i përngajë një populli, atëherë ai është prej atij populli”.

Transmeton Temimë Ed-Dariji se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. duke thënë:

“Do të kumtohet kjo çështje ashtu qartë, siç dallohet nata prej ditës. Allahu nuk do të lejë asnjë shtëpi në të cilën do të depërtojë feja e Tij, e të mos i lartësojë të lartësuarit ose të mos i nënçmojë të nënçmuarit, pra Allahu e ngritë dhe lartëson islamit dhe ata të cilët besojnë”.

Pastaj ka treguar Temimë Ed-Dariu se këtë e kanë përjetuar dhe e kanë kuptuar nëpërmjet familjes dhe farefisit tim. Ata të cilët e kanë pranuar islamit janë ngritur, janë nderuar, janë lartësuar dhe u janë dhënë të gjitha të mirat, ndërsa ata të cilët nuk kanë besuar i ka kapluar nënçmimi, poshtërimi dhe xhizja.

(Musnedi i Imam Ahmedit, 16344)

Hasan El-Basriu (në lidhje me këtë) ka thënë: E kanë nënvlerësuar dhe kanë bërë gabime, po ta kishin çmuar, dhe ta kishin ngritur fenë e tyre, ajo do t'i kishte mbrojtur.

Disa prej dijetarëve të gjeneratave të para kanë bërë këtë lutje:

“O Zot! im më ngrit me dëgjueshmërinë ndaj Teje dhe mos më poshtëro me gabimet e mijë ndaj Teje”.

Vëlla!

Nëse mëkatari vishet me rrobat më të shtrenjta, nëse banon në pallatet më të mira, nëse posedon veturat më të mira, prapë se prapë nënçmimi i gabimit gjendet në zemrën e tij dhe është i pandashëm. Prandaj, mos u mashtro me formën dhe pamjen e jashtme të tij, ose buzëqeshjet dhe të qeshurit e tij, sepse ai në mbrëmje kur të shkojë në shtëpinë e tij, nënçmimi i mëkatit ia ka mbuluar zemrën e tij.

10. Kanosja e shkatërrimeve në tokë

Prej pasojave të mëkateve është edhe kanosja e shkatërrimeve në ujë, në qiell, në perime, në pemë, në banesa etj. etj.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Është paraqitur shkatërrimi në tokë e në det, për shkak të veprimit të njerëzve (gabimeve), për ta shijuar atë çka vetë e kanë vepruar, ndoshta do të kthehen (pendohen)”.

(Err-Rrum, 41)

“Nuk ju kemi bërë padrejtësi atyre, por ata iu kanë bërë padrejtësi vetës së tyre”.

(En-Nahl, 118)

Vëlla!!

Mëkatet janë si plagët, në shumicën e rasteve ka plagë të vdekjes, falë Zotit ne nuk kemi plagë të vdekjes, mirëpo prapë se prapë plagët tona po rrjedhin, andaj e kemi për detyrë që sa më parë t'i shërojmë me pendim, para se të marrin përmasa të mëdha, të cilat na shpien në shkatërrim. Zoti na mbrojt prej shkatërrimit dhe Xhehenemit!

Vëlla!!

Në disa raste ne shikojmë çka na ka ndodhur, ose çka ju ka ndodhur njerëzve dhe me habi themi: Pse o Zot të na ndodhë kjo!? Ndërsa, ne harrojmë se çka kemi vepruar më herët; ne harrojmë se i kemi bërë padrejtësi vetës sonë; ne harrojmë çka kemi vepruar, ndërsa vetëm pyesim se çka na ka ndodhur!

Për Zotin, çdo pasojë (shkatërrim) që ta shohësh është për shkak të mëkatit. Mos thuaj: *pse këtij i ndodhi kjo?! Mos thuaj: përse më ndodhi mua kjo?! Por, duhet ai dhe ti, të mendoni për mëkatet e juaja, e pastaj ta akuzoni veten për mëkate dhe neglizhencë.*

Transmeton Ebi Musa se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Çka e kaplon robin, prej tragjeditive dhe fatkeqësive, është vetëm shkak i mëkateve, ndërsa çka falë Zoti është falje më e madhe”.

Aliu r.a. ka thënë:

“Çdo bela apo sprovë ndodh për shkak të mëkateve dhe çdo bela apo sprovë tejkalohet vetëm me pendim”.

11. Përfundimi i keq

Njëra prej pasojave më të rrezikshme të mëkateve është përfundimi i keq, pra përfundimi i mëkatarëve është përfundim i keq. Atëherë të tradhton gjuha, kur ke nevojë më së shumti për të, prandaj nuk ke mundësi të shqiptosh *Shahadetin* (La ilahe il-lallah Muhamedun resulallah) pranë vdekjes, e kjo është shkak i mëkateve! I thuhet mëkatarit: Thuaj *La ilahe il-lallah*, e ai nuk mundet, sepse gjuha nuk ia thotë, pse gjuha i është shtangur dhe përgjigjen e vërtet s’ka mundësi ta thotë, thua se në gjuhën e tij është ngarkuar një kodër.

A e dini pse?!

Kjo është pasojë e mëkateve të cilat e kanë shpjerë në greminë të thellë të shkatërrimit. Zoti na mbrojt nga mëkatet dhe shkatërrimi!

Vështro dhe analizo!

Një njeri të cilin e kam njohur më ka thënë: Isha në aeroplan me disa shokë të pasur dhe biznesmenë dhe derisa qëndroja, kur në karrigen pranë, njërit i erdhi shtangimi i vdekjes, kur njëri prej shokëve e hetoi dëshiroi t’ia përkujtojë fjalën “La ilahe il-lallah”.

Ai thoshte: - Më jep çantën.

- Thuaj: “La ilahe il-lallah”.

Ai thoshte: - Ma jep çantën.

- Thuaj: “La ilahe il-lallah”.

Çdoherë kur i shtanguari për vdekje dëshironte ta thoshte Shahadetin, nuk mundej dot, kështu që ishte e pamundur të thoshte “La ilahe il-lallah”!

Vëlla!

Mos u bën prej atyre që kur është diku që nuk ka prani të njerëzve bën mëkate, e kur të jetë në prani të njerëzve, atëherë ndalet. Këtë kategori të njerëzve Allahu e urren shumë.

Transmeton Thubani se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Do t’i kuptoni disa grupe njerëzish prej umetit tim të cilët në Ditën e Kijametit do të vijnë me punë të mira aq shumë, sa kodra, ndërsa Allahu do t’i bën pluhur e hi, të pavlefshme”.

Thubani e ka pyetur: - O i dërguar i Allahut, na cilëso ata, na sqaro kush janë ata, që të mos jemi ne prej tyre, duke mos ditur.

U përgjigj i Dërguari: “Ata janë vëllezërit e juaj dhe prej juve, qëndrojnë me ju natën, ashtu siç mendoni ju, por ata janë popull që kur të jenë të vetmuar i thyejnë ligjet e Allahut dhe bëjnë harame”.

Vëllezër!

Ruajuni nga mospërfillja e ligjeve të Allahut haptazi dhe fshehtazi, ruani dhe mos i veproni të ndaluarat atëherë kur jeni të vetmuar e nuk e di askush!

A nuk i patë pasojat dhe rreziqet e mëkateve?!
A nuk na paralajmërojnë këto pasoja të mëkateve dhe gabime që sa ma shpejt të angazhohemi e t'i lëmë ato?

A nuk na bëjnë me dije këto pasoja që t'iu tregojmë të gjithë njerëzve, t'ua tërheqim vërejtjen, t'i qortojmë, t'i thërrasim dhe t'u përkujtojmë?!

Shiko!

Ndonjëherë nuk përfillë urdhëratë e Allahut, ndërsa Allahu është i butë, të bën mirë, pastaj prapë mëkaton, ndërsa Allahu është i butë të bën mirë, të len hapësirë dhe të jep shansin të pendohesh, Allahu nuk të dënon menjëherë, e prapë ti mendon keq dhe e keqkupton Allahun. Allahu nuk është i kënaqur kurrë me të keqen dhe imoralitetin. Allahu kurrë nuk dëshiron t'i thyejë dikush ligjet dhe urdhrat e Tij. Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:

“Zoti urren, e urrejtja e Zotit është mbi ata të cilët veprojnë harame dhe nuk përfillin urdhrat e Tij”.

(Sahih Buhari, 4822)

E vërteta të cilën duhet ta dish o mëkatar është se Allahu është i butë, i urtë dhe dëshiron që të të bëjë mirë. Ti je në njërën prej fazave të cilat i ka parapa Allahu deri në vdekje, e pranë vdekjes nuk mund t'i shpëtosh dënimit të Allahut, pranë vdekjes nuk të bën asgjë dobi.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“E ti kurrresi mos mendo Allahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë zullumqarët. Ai është vetëm duke i lënë ashtu (e vonon afatin) deri në (do tu vijë) ditën kur sytë e tyre do të jenë të shtangur. (Atë ditë) ata të ngutur e duke i ngritur kokat e tyre lartë, nuk mund të lëvizin sytë e tyre, e zemrat e tyre janë të zbrazëta (nga frika e trishtimi)”.

(Ibrahim, 42, 43)

“Ndërsa ata që i konsiderojnë gënjeshtër ajetet dhe argumentet tona, Ne do t'i shpijmë në humbje, gradualisht (hap pas hapi) kah nuk e kuptojnë ata”.

(El-E'araf, 182, 183)

“Dhe kur definitivisht harruan atë me çka u këshilluan (ti drejtohen Zotit), Ne ua hapëm të gjitha dyert e të gjitha çështjeve (begative), e ata u gëzuan e u dëfryen për së tepërmi, e ne befasisht i dënuam e ata mbetën të zhgënjyer”.

(El-En'amë, 44)

Vëllezër!

A po e kuptoni se në sprovën të cilën jemi ne, është mëshirë e Zotit ndaj nesh.

A e dini se Allahu i Lartëmadhëruar sikur të hidhërohej me këtë umet do t'i jepte të mirat e dynjasë, ashtu siç u ka dhënë popujve tjerë.

Mirëpo, Allahu i Lartmadhëruar i kupton, kështu që i dëmton vetëm pjesërisht, për shkak të disa mëkateve të tyre, vetëm e vetëm t'ua përkujtojë atyre dhe t'ia tërheqë vërejtjen që të kthehen dhe orientohen sinqerisht në rrugën e vërtetë, dhe të pendohen.

Allahu i Lartëmadhëruar ka thënë:

“Është paraqitur shkatërrimi në tokë e në det për shkak të veprimit (të këqijave) të njerëzve, për ta shijuar atë çka vetë e kanë vepruar, ndoshta do të kthehen (pendohen)”.

(Err-Rrum, 41)

Po sikur Allahu të na jepte të gjitha të mirat e botës, pasi që ne mëkatojmë, do të na jepte një afat, e pastaj do të na kishte dënuar befasisht, do ta kishte fundosur tokën në tërësi dhe do të kishim qenë popull i harruar njëherë e përgjithmonë. Zoti na mbrojt nga hidhërimi i Tij dhe dënimi për shkak të këqijave të robërve të Tij.

Mirëpo, Allahu i Lartmadhëruar e do këtë popull, këtë mund ta marrim si forcë e shpresës të cilën ia ka dhuruar Allahu këtij umeti, ashtu që zbret dënimi mbi ju o muslimanë, mëshirë për ju, këshillim për ju.

Vëllezër!

Shpresoj që secili prej jush, i cili vazhdimisht ka bërë mëkat që prej sot të pendohet dhe të vendosë që kurrë mos të kthehet në ato mëkate, pra të pendohet sinqerisht dhe të takohet i pastër me Allahun e Lartmadhëruar.

Vëllezër!

Umeti ynë nuk mund të qëndrojë në këmbë (nuk mund të jetë i fortë) deri sa ne vazhdimisht bëjmë mëkate.

Kjo nuk do të thotë se kurrë nuk do të bëjmë mëkate, ose nuk do të bëjmë tjetër herë gabim. Jo, deri sa jemi krijuar njerëz, nuk jemi të siguarur dhe të mbrojtur që kurrë të mos gabojmë, por qëllimi është - që të angazhohemi shpirtërisht për të mos bërë mëkate, e nëse mëkatojmë, atëherë menjëherë të pendohemi, që të mos lejojmë që mëkatet t'i udhëheqin zemrat tona dhe t'i largojnë nga rruga e Allahut të Lartmadhëruar. Transmeton Enesi r.a se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Do të gabojë çdo birë i Ademit, por gabimtarët më të mirë janë ata që pendohen”.

(“Suneni i ibni Maxhes”, 4241)

(“Sahih El-Xhamie lil alamete Albani”, 4515)

Vëlla!

Mos i harro vëllezërit në Palestinë!

Mos e harro Mesxhidi Aksan e uzurpuar!

Mos e harro Irakun e dashur!

Mos e harro se Iraku është vend islam me traditë të lashtë!

Mos e harro çka u ndodhë muslimanëve në përgjithësi!

Mos humb shpresën, pendohu dhe thirr në rrugën e Allahut!

Neve nuk na mungojnë armët, as numri i umetit, por na mungojnë shpirtat të cilat duhet të zgjohen dhe ta praktikojnë rrugën dhe planprogramin e Allahut të Lartmadhëruar dhe të Dërguarit e Tij. Shpirtat të cilat duhet ta dinë se janë përgjegjës për umetin dhe çka i ndodh atij.

Ibn Tejmije r.a. e ka thënë një fjalë shumë të urtë:

“Zemrat e singerta dhe lutjet e singerta janë ushtri të cilat nuk mposhtën kurrë”.

PËRFUNDIM

Në fund të kësaj ligjërate dhe kësaj porosie lus Allahun, që të jetë e dobishme për ata që e lexojnë, po ashtu e lus Allahun tim, që të na pranojë të gjitha veprat e mira, të na peshojë punët e mira dhe të na fshijë punët e këqija. Lus Allahun, që të më falë për gabimet, mangësitë, lajthitjet dhe harresat e mia. Dëshmoj para Allahut dhe para të gjithëve se atë çka e kam thënë të drejtë është ajo çka më ka mësuar Allahu dhe i Dërguari i Tij, ndërsa ajo çka kam lajthitë, kam gabuar, ose kam harruar, është prej meje dhe prej shejtanit. Allahu dhe i Dërguari i Tij janë të pastër, prandaj lus Allahun e Lartmadhëruar që të më falë, të m'ë fshijë gabimet mua dhe të varfërve.

Tani e Lusim Allahun më këtë dua me shpresë se do të na pranojë dhe ta bën shkak të pendimit, shkak të largimit nga mëkatet dhe të këqijave, shkak për të na udhëzuar, përmirësuar dhe për të arritur kulminacionin dhe të mirat; ta bën shkak të ngritjes, zhvillimit, përparimit, shkak të shpëtimit prej Xhenemit dhe fitimit të Xhenetit, shkak që të mos jemi të nënçmuar, të poshtëruar dhe të nënvlerësuar, por të na bëjë **umet** të zhvilluar dhe të përparuar.

JA DHE XHELALI VEL IKRAM, JA DHEL XHELALI VEL IKRAM!

O zoti ynë, ne jemi umeti i të dashurit tënd Muhamedit s.a.v.s. Ti je mbrojtësi ynë dhe Ti je mbrojtësi më i miri.

Vetëm Ti na mjafton për brengat tona. Nuk kemi kujt t'i drejtohemi pos Teje. Ti je Sunduesi absolut. Ti je i Gjalli i Përgjithmonshëm. Ti i ke në kompetencë dhe nën sundim çdo gjë, vepron çka do dhe çka dëshiron. O Sundimtar i të gjithëve, Ti i jep pushtet kujt do dhe e zbrit nga pushteti cilin do, e ngritë cilën do dhe e poshtëron cilin do. Ti i ke në dorë të gjitha të mirat, Ti ke mundësi për çdo send. Ti e zgjatë dorën natën, për t'u penduar gabimtari i ditës, dhe Ti e zgjatë dorën ditën, për t'u penduar gabimtari i natës.

Ti gëzohesh me pendimin e robit tënd. O i Gjallë i Përgjithmonshëm! JA HANNAN JA MENNAN, JA HANNAN JA MENNAN , umeti i Muhamedit kërkon ndihmë te Ti, o Zot i tokës dhe i qiejve. Na ka kapluar rreziku, ndërsa Ti je më i mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve. O Zoti ynë, jemi mundur, na ndihmo me fitore. Zoti ynë, ne jemi të dobët, nuk kemi Zot tjetër pos Teje. Kërkojmë prej Teje, o Sundimtar i të gjithëve. Kërkojmë të na falësh mëkatet tona. Na fal se s'kemi Zot pos Teje, gabimet nuk i falë askush pos Teje. Ne jemi të dobët dhe të pafuqishëm, modest dhe të thjeshtë, ne jemi të dobët në vetvete dhe ndaj tjerëve, dobësia në ne na bën që të bëjmë gabime dhe të digjemi ne zjarr. Kërkojmë mbrojtje tek Ti prej epshit tonë, të këqijave tona, mëkateve tona dhe ngatërresave tona. Kërkojmë mbrojtje nga mëkatet dhe Xhehenemi. Të lutemi na fal Xhenetin dhe vendet më të mira. Ti je Zot i të gjithë botëve, Ti je Zot i të

dobëtëve, Ti je Zoti ynë. Ne dëshirojmë vetëm kënaqësinë Tënde ndaj neve, e jo hidhërimin. Për hir të madhërisë Tënde, që me dritën Tënde shndritë dhe i fshin të gjitha errësitat dhe i sjellë të gjitha të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, largoje hidhërimin Tënd nga ne, largoje zemërimin Tënd nga ne. Kërkojmë vetëm kënaqësinë Tënde, nuk ka forcë as fuqi e cila mund të ndryshojë diçka pos Teje, Ti je një - Mbrojtësi dhe Ndhimësi ynë. JA DHEL XHELALI VEL IKRAM, JA HANNAN JA MENNAN, ndihmo vëllezërit tanë në Palestinë, Irak dhe çdo vend Islam.

O Zot, mbroji vëllezërit tanë, O Zot mbrona neve nga mëkatet tona, mbrona nga zullumqarët, nga shejtani dhe nga tradhtarët!

O Zot, pranoje këtë lutje, o Zot pranoje këtë lutje!

O Zot, dërgoje këtë përshëndetje për zotëriun tonë – Muhamedin a.s. familjen e tij, shokët e tij dhe kush i pason ata deri në Ditën e Gjykimit! Lutja e fundit përfundimtare:

FALËNDEROJMË ALLAHUN ZOTIN E GJITHË BOTËVE!

* * *

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”.
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (*Muhamed Sajim*)
2. “Islami dhe Politika” (*nga autori Jusuf Kardavi*)
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (*Abdurrezak Nufel*)
4. “Për Kushtetutën Islame” (*Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer*)
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (*Abduhu Abas El-Velidi*)
6. “Vlera e kohës” (*nga autori Amër Halid*)
7. “Vëllazëria muslimane” (*nga autori Amër Halid*)
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (*Amër Halid*)
9. “Pendimi” (*nga autori Amër Halid*)
10. “Pasojat e mëkateve” (*nga autori Amër Halid*)

Donator Shtypshkronja

“VERANA”

Pronar Ramadani

Përkthyesi falënderon donatorin, njëherit e lutë Allahun që ta shpërblejë në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe ta ngritë atë në shkallë të larta me pejgamberët, dëshmorët, të sinqertit dhe bamirësit.